



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Zhvillimit Rajonal/Ministry of Regional Development/Ministarstvo za Regionalni Razvoj

ANALIZA E INVESTIMEVE KAPITALE SIPAS RAJONEVE ZHVILLIMORE NË KOSOVË PËR VITIN 2024

DEPARTAMENTI PËR PERFORMANCË DHE ANALIZA RAJONALE





Analiza e Investimeve Kapitale sipas rajoneve zhvillimore për vitin 2024 pasqyron realizimin e investimeve kapitale në nivel rajonal. Bazuar në gjetjet ofron rekomandime orientuese për përmirësim të mëtejshëm.

Copyright. 2025 – Ministria e Zhvillimit Rajonal

Republika e Kosovës, 10000 Prishtinë

Kati: III Ndërtesa ish Rilindja, Prishtinë

<https://mzhr.rks-gov.net>

DOKUMENTI U HARTUA NGA:

SHYHRETE KASTRATI – DREJTORESHË E DEPARTAMENTIT PËR PERFORMANCË DHE ANALIZA RAJONALE;

QEFHERE BAJRAMI – UDHËHEQËSE E DIVIZIONIT PËR ANALIZA SOCIO-EKONOMIKE RAJONALE;

BLINDA BYTYÇI - ZYRTARE PËR ZHVILLIM RAJONAL TË BALANCUAR;

Përmbajta:

Hyrje	7
Metodologjia	8
Përmbledhje ekzekutive.....	9
Lista e shkurtesave:.....	10
Përkufizime:	11
Rajonet zhvillimore sipas fushëveprimtarisë së Ministrisë së Zhvillimit Rajonal:.....	12
KAPITULLI I.....	13
I. INVESTIMET E PËRGJITHSHME KAPITALE - NIVELI QENDROR	13
1.1 Investimet e përgjithshme kapitale për vitin 2024 nga Ministrinë dhe Institucionet tjera të nivelit qendror në shtatë (7) Rajone Zhvillimore	13
1.2 Ministrinë dhe vlera e investimeve kapitale të realizuara gjatë vitit 2024	15
KAPITULLI II	25
II. SHPËRNDARJA E BALANCUAR E INVESTIMEVE KAPITALE TË MINISTRIVE TË LINJES NË SHTATË (7) RAJONE ZHVILLIMORE	25
2.1 Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe shpërndarja e balancuar e investimeve kapitale për vitin (2024) sipas shtatë (7) rajoneve zhvillimore:	26
<i>Figura 3. Sektorët e financuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal v.2024</i>	<i>27</i>
<i>Figura4. Sektorët e financuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal v.2024.....</i>	<i>28</i>
<i>Tabela9 . Projektet e financuara nga Ministria e Zhvillimit Rajonal në (7) rajone zhvillimore për vitin 2024, sipas vlerës financiare dhe sektorit</i>	<i>29</i>
II. 2 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe shpërndarja e balancuar e investimeve kapitale për periudhën (2024) sipas (7) rajoneve zhvillimore.....	33
<i>Tabela 10. Totali i investimeve dhe i projekteve të financuara nga MAPL në 7 rajone zhvillimore v.2024.....</i>	<i>33</i>
<i>Tabela 11. Projektet e financuara nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në (7) rajone zhvillimore për vitin 2024, sipas vlerës financiare dhe sektorit.....</i>	<i>36</i>
<i>Figura 9. Shpërndarja e Investimeve në (7) rajone zhvillimore për vitin 2024, nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal</i>	<i>39</i>
<i>Figura 10. Shpërndarja e Investimeve në % në (7) rajone zhvillimore për vitin 2024, nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal</i>	<i>40</i>
2.3 Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe shpërndarja e balancuar e investimeve kapitale për vitin 2024 sipas (7) rajoneve zhvillimore	41
<i>Tabela 13. Projektet e financuara nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit në (7) rajone zhvillimore për vitin 2024, sipas vlerës financiare dhe sektorit</i>	<i>44</i>
<i>Figura 13. Shpërndarja e Investimeve në (7) rajone zhvillimore për vitin 2024, nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit</i>	<i>50</i>
<i>Figura 14. Shpërndarja e Investimeve në % në (7) rajone zhvillimore për vitin 2024, nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.....</i>	<i>51</i>
II.4 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit si dhe shpërndarja e balancuar e investimeve kapitale për vitin (2023) sipas shtatë (7) rajoneve zhvillimore	52
<i>Fifura 15. Sektorët e financuar nga MASHT për vitin 2024.....</i>	<i>53</i>
<i>Figura 16. Sektorët e financuar nga MASHT në % për vitin 2024.....</i>	<i>54</i>
<i>Figura 18. Shpërndarja e Investimeve në % në (7) rajone zhvillimore për vitin 2024, nga Ministria e Arsimit, Shencës dhe Teknologjisë.....</i>	<i>61</i>
2.5. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe shpërndarja e balancuar e investimeve kapitale për vitin (2024) sipas (7) rajoneve zhvillimore.....	62
<i>Tabela 16. Totali i investimeve dhe i projekteve të financuara nga Ministria e Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Industrisë në shtatë (7) rajone zhvillimore v.2024.....</i>	<i>62</i>
<i>Figura 19. Sektorët e financuar nga Ministria e Tregtisë dhe Indusrisë për vitin 2024</i>	<i>63</i>
<i>Figura 20. Sektorët e financuar në % nga Ministria e Tregtisë dhe Indusrisë për vitin 2024.....</i>	<i>64</i>

2.6 Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës MMPHI dhe shpërndarja e balancuar e investimeve kapitale për vitin (2024) sipas shtatë (7) rajoneve zhvillimore	69
<i>Tabela 18. Totali i investimeve dhe i projekteve të financuara MMPHI, në shtatë (7) rajone zhvillimore v.2024</i>	<i>69</i>
<i>Figura 26. Sektorët e financiar në % nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në shtatë 7 rajone zhvillimore për vitin 2024</i>	<i>78</i>
.....	81
2.7 Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe shpërndarja e balancuar e investimeve kapitale për vitin 2024 sipas shtatë (7) rajoneve zhvillimore	83
<i>Tabela 22. Totali i investimeve dhe i projekteve të financuara nga Ministria për Komunitet dhe Kthim në shtatë (7) rajone zhvillimore v.2024</i>	<i>83</i>
<i>Figura 29. Totali i investimeve kapitale nga Ministria për Komunitet dhe Kthim, për vitin 2024</i>	<i>87</i>
<i>Figura 30. Totali i investimeve kapitale nga Ministria për Komunitet dhe Kthim, për vitin 2004 në %</i>	<i>87</i>
2.8 Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural MPBZHR dhe shpërndarja e balancuar e investimeve kapitale për vitin 2024 sipas shtatë (7) rajoneve zhvillimore	88
<i>Tabela 24. Totali i investimeve dhe i projekteve të financuara nga Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në shtatë (7) rajone zhvillimore, v.2024</i>	<i>88</i>
<i>Figura 31. Sektorët e financiar nga Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në shtatë (7) rajone zhvillimore, v.2024</i>	<i>89</i>
<i>Figura 32. Sektorët e financiar në % nga Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në shtatë (7) rajone zhvillimore, v.2024</i>	<i>89</i>
<i>Tabela 25. Projektet e financuara nga Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në shtatë (7) rajone zhvillimore për vitin 2024 sipas vlerës financiare dhe sektorit</i>	<i>90</i>
2.9 Ministria e Ekonomisë dhe shpërndarja e balancuar e investimeve kapitale për vitin (2024) sipas (7) rajoneve zhvillimore	94
<i>Tabela 26. Totali i investimeve dhe i projekteve të financuara nga Ministria e Ekonomisë në shtatë (7) rajone zhvillimore, v.2024</i>	<i>94</i>
<i>Figura 36. Sektorët e financiar nga Ministria e Ekonomisë për vitin 2024</i>	<i>96</i>
<i>Tabela 27. Projektet e financuara nga Ministria e Ekonomisë në shtatë (7) rajone zhvillimore për vitin 2024, sipas vlerës së financimit dhe sektorit</i>	<i>97</i>
<i>Tabela 28. Mesatarja e diskrepancës së shpërndarjes të projekteve kapitale nga ministrinë e linjës për vitin 2024.</i>	<i>101</i>
KAPITULLI III.....	102
III. SHPËRNDARJA E INVESTIMEVE KAPITALE E MINISTRIVE ME NDIKIM TË TË TËRTHORTË NË ZHVILLIM SOCIO-EKONOMIK	102
3.1 Ministria e Shëndetësisë (MSH)	102
<i>Tabela 29. Totali i investimeve dhe i projekteve të financuara nga Ministria e Shëndetësisë për vitin 2024</i>	<i>102</i>
<i>Figura 39. Sektorët e financiar nga Ministria e Shëndetësisë, për vitin 2024</i>	<i>103</i>
<i>Figura 40. Sektorët e financiar në % nga Ministria e Shëndetësisë, për vitin 2024</i>	<i>103</i>
<i>Figura 42. Sektorët e financiar me % nga Ministria e Shëndetësisë, për vitin 2024</i>	<i>106</i>
3.2 Ministria e Mbrojtjes (MM)	107
<i>Tabela 31. Totali i investimeve dhe i projekteve të financuara nga Ministria e Shëndetësisë për vitin 2024</i>	<i>107</i>
<i>Figura 43. Sektorët e financiar në Kazerma nga MM v.2024</i>	<i>108</i>
<i>Figura 44. Sektorët e financiar në Rajonin Qendër (Prishtinë) nga MM v.2024</i>	<i>108</i>
3.3 Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)	109
<i>Figura 46. Totali i investimeve kapitale nga Ministria e Punëve të Brendshme, për vitin 2024</i>	<i>114</i>
<i>Figura 47. Totali i investimeve kapitale në % nga Ministria e Punëve të Brendshme, për vitin 2024</i>	<i>115</i>
3.4 Ministria e Drejtësisë (MD)	116
<i>Figura 48. Sektorët e financiar nga Ministria e Drejtësisë për vitin 2024</i>	<i>117</i>
<i>Figura 49. Totali i investimeve kapitale në % nga Ministria e Drejtësisë, për vitin 2024</i>	<i>117</i>

3.5 Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diaspora	118
3.6 Ministria e Financave Punës dhe Transfereve.....	119
<i>Figura 50. Sektorët e financuar nga Ministria Financave Punës dhe Transfereve v.2024</i>	120
<i>Figura 51. Investimet kapitale sipas 7 rajoneve zhvillimore nga Ministria Financave Punës dhe Transfereve v.2024.....</i>	124
KAPITULLI IV	125
IV. INVESTIMET E PËRGJITHSHME KAPITALE NGA NIVELI LOKAL - 2024.....	125
4.1 Rajoni Zhvillimor Qendër	136
4.2 Rajoni Zhvillimor Veri	150
4.3 Rajoni Zhvillimor Perendim.....	163
4.4 Rajoni Zhvillimor Jug	175
4.5 Rajoni Zhvillimor Juglindje	187
4.6 Rajoni Zhvillimor Lindje.....	199
4.7 Rajoni Zhvillimor Jugperendim.....	212
Përfundime dhe rekomandime.....	223
Burimet e informacionit.....	225

Hyrje

Investimet kapitale luajnë një rol kyç në zhvillimin ekonomik, social dhe infrastrukturor të rajoneve zhvillimore, duke shërbyer si bazë për përmirësimin e mirëqenies së përgjithshme dhe nxitjen e rritjes së qëndrueshme. Nëpërmjet tyre, realizohen projekte që sjellin përfitime afatgjata dhe që ndikojnë në çdo aspekt të jetës së qytetarëve. Rëndësia e investimeve kapitale mund të përmbledhet në disa aspekte kryesore që ndikojnë në zhvillimin ekonomik, social dhe infrastrukturor të rajoneve zhvillimore, si:

- Zhvillimi ekonomik dhe krijimi i vendeve të punës, ku investimet kapitale kontribuojnë në rritjen ekonomike, mundësojnë zhvillimin e infrastrukturës dhe objekteve publike, duke krijuar një mjedis të favorshëm për bizneset dhe investimet private.
- Reduktimi i pabarazive rajonale, i cili është një nga objektivat më të rëndësishme të investimeve kapitale në të cilën përfshihet shpërndarja e balancuar mes rajoneve të ndryshme, duke synuar reduktimin e pabarazive socio – ekonomike dhe krijimin e kushteve të barabarta për zhvillim, veçanërisht për zonat rurale ose vendbanimet më pak të zhvilluara.
- Përmirësimi i cilësisë së jetës, ku investimet kapitale ndikojnë drejtëpërdrejtë në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve përmes projekteve që mbështesin arsimin, shëndetësinë dhe aktivitetet kulturore.
- Investime në sektorë strategjikë, si teknologjia dhe industria, të cilët kontribuojnë në përmirësimin e konkurrueshmërisë dhe rritjen e kapaciteteve eksportuese të vendit. Për më tepër ato mbështesin zhvillimin e inovacionit dhe përmirësimin e kapaciteteve teknologjike, duke fuqizuar ekonominë rajonale në tregun global gjithnjë e më të integruar.

Investimet kapitale janë shtyllë e domosdoshme për zhvillimin socio – ekonomik të rajoneve zhvillimore, për zhvillimin e një ekonomie të balancuar dhe të qëndrueshme, duke garantuar përfitime afatgjata për të gjitha rajonet zhvillimore. Analiza e Investimeve Kapitale sipas Rajoneve Zhvillimore për vitin 2024, fokusohet në pasqyrimin e investimeve kapitale të Republikës së Kosovës në kontekstin e zhvillimit socio – ekonomik rajonal e cila është një ndër kategoritë më të rëndësishme të shpenzimeve buxhetore. Ajo ofron një pasqyrë të shpërndarjes së investimeve dhe përdor të dhënat për vlerësimin e investimeve për kokë banori, duke mundësuar analizimin e nivelit të investimeve në raport me popullsinë në rajone dhe komuna të ndryshme, si dhe krahasimin e tyre në nivel rajonal. Kjo analizë, e përgatitur nga Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR), ofron një pasqyrë të plotë të planifikimit dhe realizimit të investimeve kapitale për vitin 2024 e cila përfshinë të dhëna nga të gjitha organizatat buxhetore si nga niveli qendror ashtu edhe nga ai lokal. Analiza fokusohet në ndarjen dhe pasqyrimin e investimeve kapitale të Republikës së Kosovës në kontekstin e zhvillimit socio – ekonomik rajonal, sipas shtatë rajoneve zhvillimore të Kosovës: Qendër, Veri, Perëndim, Jug, Juglindje, Lindje dhe Jugperëndim.

Metodologjia

Ky dokument është hartuar duke marr për bazë legjislacionin në fuqi, Raportin e Ndarjeve Buxhetore dhe Shpenzimeve të Investimeve Kapitale për vitin 2024, të dhënat nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve /Thesari I Kosovës, bazuar në Sistemin Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës-SIMFK, të cilat janë analizuar dhe krahasuar, si dhe komentet e pranuar me shkrim nga ministrit, insitucionet tjera relevante dhe komunat.

Në pjesën e parë të analizës është përfshirë çasje e përgjithshme e këndvështrimit të investimeve kapitale nga niveli qendror, duke vazhduar me pjesën e nivelit lokal, që kanë të bëjnë me planifikimin buxhetor dhe realizimin e investimeve si nga grantet qeveritare, nga të hyrat vetanake si dhe të hyrat vetanake të bartura nga viti paraprak.

Dokumenti është konsultuar në vazhdimësi në mënyrë elektronike me ministritë dhe komunat në lidhje me të dhënat e kërkuara sipas rajoneve zhvillimore në mënyrë që të kemi një saktësi në të dhëna dhe të gjeturat të prezantohen në mënyrë sa më profesionale.

Përmbledhje ekzekutive

Analiza e Investimeve Kapitale për vitin 2024, paraqet një vlerësim të hollësishëm mbi shpërndarjen e investimeve nga niveli qendror dhe lokal në shtatë (7) rajonet zhvillimore: Qendër, Veri, Perëndim, Jug, Juglindje, Lindje dhe Jugperëndim.

Në këtë dokument janë analizuar investimet në shtatë rajone zhvillimore, si dhe janë përfshirë të gjitha planifikimet dhe realizimi i shpenzimeve të të gjitha organizatave buxhetore nga të dy nivelet qendror dhe ai lokal, duke siguruar një pasqyrë gjithëpërfshirëse mbi shpërndarjen e burimeve financiare dhe ndikimin e tyre.

Duke pasur parasysh mandatin dhe vizionin e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal (MZHR) për të promovuar një zhvillim rajonal të balancuar, analiza ofron një përshkrim të investimeve kapitale të ndara sipas rajoneve dhe konkretizohet në nivel komunal. Ajo përfshin shpërndarjen e fondeve në çdo komunë, numrin e projekteve të realizuara si dhe të gjithë sektorët e financiar.

Pra, ky dokument shfaq qartë ndryshimet mes rajoneve dhe komunave lidhur me përkrahjen nga niveli qendror dhe zbatimin e projekteve kapitale nga niveli lokal gjatë vitit 2024. Investimet kapitale nga niveli Qendror për vitin 2024 arrijnë vlerën €412,108,269.59 nga gjithsej €555,818,251.14 vlera e planifikuar nga fondet burimore (10 buxheti dhe donatorët e ndryshëm)¹. Realizimi i buxhetit nga kjo kategori arrin 74% të realizimit të buxhetit për projekte kapitale. Investimet kapitale në shtatë rajone zhvillimore sipas nivelit lokal arrijnë vlerën € 242,518,047.56 nga € 296,261,148.29 të planifikuara për vitin 2024, me 82% të realizimit të buxhetit për projekte kapitale nga fondet burimore (10 buxheti, 21 të hyrat vetanake, 22 të hyrat vetanake nga viti i kaluar dhe donatorët e ndryshëm)².

Analiza e investimeve kapitale synon të promovojë një zhvillim rajonal të balancuar duke adresuar dallimet ekzistuese mes rajoneve të ndryshme apo më pak të zhvilluara në aspektin socio-ekonomik. Komunitet e vogla, të cilat varen në masë të madhe nga buxheti qendror (granti qeveritar) dhe investimeve të ministrive, si dhe përballen me sfida të shumta. Përmes kësaj analize, MZHR synon të ofrojë një udhëzues të qartë për politikën e ardhshme zhvillimore, duke theksuar rëndësinë e shpërndarjes së drejtë dhe efektive të burimeve për përmirësimin e standardit të jetesës dhe zhvillimin e gjithanshëm socio-ekonomik.

¹ PK 2024 (Thesari i Kosovës)

² PK 2024 (Thesari i Kosovës)

Lista e shkurtesave:

MZHR - Ministria e Zhvillimit Rajonal;

MFPT - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve;

LMFPP - Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi;

SIMFK - Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës;

OB - Organizata Buxhetore;

KASH - Korniza Afatmesme e shpenzimeve;

AZHR - Agjensionet për Zhvillim Rajonal;

ML - Ministritë e Linjës;

RZHQ - Rajoni Zhvillimor Qendër;

RZHV - Rajoni Zhvillimor Veri;

RZHP - Rajoni Zhvillimor Perëndim;

RZHJ - Rajoni Zhvillimor Jug;

RZHJL - Rajoni Zhvillimor Juglindje;

RZHL - Rajoni Zhvillimor Lindje;

RZHJP - Rajoni Zhvillimor Jugperëndim.

Përkufizime:

Rajon zhvillimor« - nënkupton territorin funksional që përfshinë dy apo më shumë njësi të vetëqeverisjes lokale, në përputhje me kriteret e NUTS-3, për zbatimin e politikave të zhvillimit rajonal, i cili dallohet nga një tërësi karakteristikash gjeografike, socio-ekonomike, kulturore, mjedisore. Rajoni zhvillimor përfshinë zhvillimin socio-ekonomik rajonal të balancuar, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi dhe në asnjë rrethanë nuk nënkupton organizim administrativ apo territorial.

Zhvillimi rajonal « është një përpjekje e përgjithshme për të reduktuar pabarazitë rajonale, duke mbështetur (punësimin dhe gjenerimin e pasurisë/mirëqenies) aktivitete ekonomike në rajone;

Pabarazi rajonale « nënkupton gjendjen kur evidentohen dallime substanciale në mes të rajoneve zhvillimore sipas indikatorëve socio-ekonomik.

Zhvillimi i balancuar rajonal « nënkupton procesin e uljes së dallimeve në aspekt të zhvillimit socio-ekonomik si dhe përafrimi i nivelit të zhvillimit ekonomik, social, kulturor e mjedisor, ndërmjet rajoneve të ndryshme zhvillimore përmes shfrytëzimit të potencialeve të tyre sa i përket resurseve financiare, natyrore dhe kapitalit njerëzor.

Politikat për zhvillim rajonal « - nënkuptojnë kornizën e dokumenteve strategjike dhe planifikuese të zhvillimit rajonal me qëllim të intervenimeve në fusha të caktuara të cilat do të zbatohen për arritjen e synimit të zhvillimit të balancuar rajonal. Varësisht nga ndryshimet dhe avancimi i dokumenteve strategjike, objektivat e zhvillimit rajonal, do t'i referohen dhe adaptohen ndryshimeve të fundit.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim « është një dokument i cili ka për synim që t'i adresojë pengesat kryesore për zhvillimin e Kosovës dhe përfaqëson një dokument nismash zhvillimore të cilat janë objektiva kombëtare që kanë konsensus të gjerë shoqëror;

Projekt Kapital « një investim afatgjatë që përdoret për të ndërtuar, rritur ose përmirësuar asetet, sipas kriterëve të përcaktuara, ashtu siç është përcaktuar me Udhëzimin Administrativ Nr. 04/2019 për Definimin e Projekteve Kapitale dhe Klasifikimin e Shpenzimeve të Projekteve Kapitale

Rajonet zhvillimore sipas fushëveprimtarisë së Ministrisë së Zhvillimit Rajonal:

01 - Rajoni Zhvillimor Qendër;

02 - Rajoni Zhvillimor Veri;

03 - Rajoni Zhvillimor Perëndim;

04 - Rajoni Zhvillimor Jug;

05 - Rajoni Zhvillimor Juglindje;

06 - Rajoni Zhvillimor Lindje;

07 - Rajoni Zhvillimor Jugperëndim.


KAPITULLI I

I. INVESTIMET E PËRGJITHSHME KAPITALE - NIVELI QENDROR

1.1 Investimet e përgjithshme kapitale për vitin 2024 nga Ministritë dhe Institucionet tjera të nivelit qendror në shtatë (7) Rajone Zhvillimore

Ky dokument paraqet një pasqyrë të investimeve kapitale të realizuara nga ministritë e nivelit qendror gjatë periudhës raportuese. Analiza synon të evidentojë shumat e planifikuara dhe të shpenzuara, nivelin e realizimit, si dhe ndikimin socio-ekonomik të projekteve në nivel kombëtar, rajonal dhe komunal.

Kjo analizë reflekton investimet e nivelit qendror, të ndara sipas komunave, sektorëve dhe rajoneve, duke u bazuar në metodologjinë që Ministria e Zhvillimit Rajonal që aplikon gjatë hartimit të analizës vjetore me ndikim socio-ekonomik rajonal të balancuar.



Të dhënat e paraqitura shërbejnë si bazë për vlerësimin e performancës institucionale dhe për përmirësimin e politikave publike të investimeve. Analiza përfshin të dhëna mbi planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve për investime kapitale, si dhe numrin e projekteve të financuara, të paraqitura sipas vlerës financiare për vitin 2024 dhe të realizuara nga ministritë, agjencitë dhe institucionet e tjera të nivelit qendror dhe nivelit lokal.

Sipas raportit vjetor të shpenzimeve për investime kapitale, në vitin 2024 nga niveli qendror janë realizuar investime kapitale në vlerë prej €412,108,269.59, nga gjithsej €555,818,251.14 sa ishte vlera e planifikuar. Këto investime përfshijnë realizimin e projekteve kapitale nga ministritë, institucionet e tjera të nivelit qendror (Kuvendi, agjencitë, komisionet, etj.), si dhe nga donatorët.

Tabela 1. Investimet e përgjithshme kapitale për vitin 2024 nga Niveli Qendror

Investimet Kapitale v.2024 - Niveli Qendror			
	Buxheti i planifikuar v.2024	Buxheti i shpenzuar v.2024	% e realizimit të buxhetit v.2024
Ministritë	€ 438,818,285.56	€ 352,579,954.88	80%
Institucionet tjera nga niveli Qendror si: (Agjencionet, Kuvendi, ZKM, ZP etj)	€ 32,185,368.00	€ 25,713,945.69	80%
Donatorët të ndryshëm të institucioneve të tjera (Kuvend, Agjenci, Gjykata, ZKM etj)	€ 2,337,798.18	€ 1,362,285.96	58%
Donatorët të ndryshëm(ministri)	€ 82,476,799.40	€ 32,452,083.06	39%
Gjithsej	€ 555,818,251.14	€ 412,108,269.59	74%

1.2 Ministritë dhe vlera e investimeve kapitale të realizuara gjatë vitit 2024

Të dhënat në tabelën në vijim paraqesin vlerësimet financiare të investimeve kapitale të realizuara nga ministritë e nivelit qendror gjatë vitit 2024. Pasqyrohen dy komponentë kryesorë: buxheti aktual i planifikuar për investime kapitale dhe shuma aktuale e shpenzuar, bazuar në ekzekutimin real të projekteve. Këto të dhëna mundësojnë një vlerësim të qartë të performancës së ministrive në zbatimin e projekteve kapitale, si dhe të shkallës së realizimit të tyre në raport me buxhetin e paraparë. Totali i buxhetit të planifikuar për projekte kapitale është 438,818,285,56€ ndërsa shpenzimet e realizuara arrijnë në 352,579,954.88€ që përfaqëson një nivel të përgjithshëm të realizimit rreth 80%. Ky rezultat reflekton dinamika të ndryshme të zbatimit të projekteve ndërmjet ministrive, të ndikuara varësisht nga natyra e investimeve. Të dhënat shërbejnë si bazë për analizën e mëtejshme të performancës së secilës ministri, identifikimin e fushave me progres domethënës dhe atyre që kërkojnë përmirësim, si dhe për vlerësimin e ndikimit të përgjithshëm socio-ekonomik të investimeve kapitale në nivel kombëtar dhe rajonale.

Tabela 2. Investimet e përgjithshme kapitale për vitin 2024 nga Niveli Qendror (Ministritë)

NIVELI QENDROR - INVESTIMET KAPITALE 2024				
10 BUXHETI				
Nr.	Institucioni	Buxheti Aktual/ Planifikuar (€)	Aktuali/Shpenzuar (€)	% e realizimit
1	201 MINISTRIA E FINANCAVE, PUNËS DHE TRANSFEREVE	€ 11,003,927.00	€ 4,881,772.55	44%
2	203 MINISTRIA E BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL	€ 1,038,332.00	€ 685,850.79	66%
3	204 MINISTRIA E INDUSTRIË, NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË	€ 6,421,000.00	€ 1,649,503.97	26%
4	205 MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKT	€ 182,030,915.00	€ 153,462,636.20	84%
5	206 MINISTRIA E SHËNDETËSISË	€ 9,897,121.82	€ 5,711,375.59	58%
6	207 MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT	€ 43,126,166.27	€ 26,172,158.30	61%
7	208 MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT	€ 26,255,069.47	€ 16,580,578.37	63%
8	211 MINISTRIA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM	€ 1,810,000.00	€ 1,416,151.63	78%
9	212 MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL	€ 4,950,000.00	€ 4,026,495.81	81%
10	213 MINISTRIA E EKONOMISË	€ 1,295,747.00	€ 808,263.06	62%
11	214 MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME	€ 53,444,565.00	€ 44,274,841.94	83%
12	215 MINISTRIA E DREJTËSISË	€ 2,835,000.00	€ 2,029,337.66	72%
13	216 MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME DHE DIASPORA	€ 3,677,725.00	€ 3,143,539.42	85%
14	217 MINISTRIA E MBROJTJES	€ 88,041,260.00	€ 84,853,763.95	96%
15	221 MINISTRIA E ZHVILLIMIT RAJONAL	€ 2,991,457.00	€ 2,883,685.64	96%
	Gjithsej	€ 438,818,285.56	€ 352,579,954.88	80%

Figura 1. Përqindja e realizimit të buxhetit të investimeve kapitale nga niveli qendror(ministrive), për vitin v.2024




Tabela 3. Investimet e përgjithshme kapitale për vitin 2024 nga Niveli Qendror (Institucionet tjera)

NIVELI QENDROR - INVESTIMET KAPITALE 2024				
10 BUXHETI				
Nr.	Institucioni	Buxheti Aktual/ Planifikuar (€)	Aktuali/Shpenzuar (€)	% e realizimit
1	101 Kuvendi	€ 60,000.00	-	0%
2	102 Zyra e Presidentit	€ 94,000.00	€ 24,560.59	26%
3	104 Zyra e Kryeministrit	€ 89,000.00	€ 82,882.30	93%
4	243 Gjykata Kushtetuese	€ 120,000.00	€ 87,181.40	73%
5	328 Këshilli Gjyqësor I Kosovës	€ 3,420,523.00	€ 2,337,004.06	68%
6	250 Këshilli Prokurorial I Kosovës	€ 798,182.00	€ 583,363.00	73%
7	230 Komisioni Rregullativ I Prokurimit	€ 160,000.00	€ 21,594.00	14%
8	235 Autoriteti Rregullator I Komunikimeve Elektronike dhe Postare	€ 600,000.00	€ 109,360.00	18%
9	238 Zyra e Rregullatorit të Energjisë së Kosovës	€ 102,800.00	€ 45,252.56	44%
10	302 Zyra Kombëtare e Auditimit	€ 150,000.00	€ 120,523.68	80%
11	245 Agjencia e Kosovës për Inteligjencë	€ 2,198,847.00	€ 1,867,695.74	85%
12	329 Agjencia Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës	€ 280,000.00	€ 214,770.00	77%
13	236 Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit	€ 94,000.00	€ 88,517.50	94%
14	254 Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror	€ 1,427,516.00	€ 1,425,423.60	100%
15	239 Agjencia Kosovare e Privatizimit	€ 60,000.00	€ 56,188.00	94%
16	242 Universiteti I Prishtinës	€ 5,100,000.00	€ 5,056,555.90	99%
17	220 Shërbimi Spitalor Klinik Universitar	€ 13,837,500.00	€ 13,039,945.53	94%
18	322 Akademia e Drejtësisë	€ 50,000.00	€ 48,548.51	97%
19	318 Komisioni I Pavarur për Miniera dhe Minerale	€ 265,000.00	€ 177,433.28	67%
20	319 Komisioni I Pavarur për Media	€ 858,000.00	€ 303,147.04	35%
21	313 Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit	€ 100,000.00	-	0%
22	314 Autoriteti Rregullativ I Hekurudhave	€ 20,000.00	€ 20,000.00	100%
23	317 Autoriteti I Aviacionit Civil të Kosovës	€ 20,000.00	€ 3,999.00	20%
24	320 Komisioni Qendror I Zgjedhjeve	€ 870,000.00	-	0%
25	232 Shpenzimet e Paparashikuara	€ 1,410,000.00	-	0%
	Gjithsej	€ 32,185,368.00	€ 25,713,945.69	80%

Tabela 4. Investimet e përgjithshme kapitale për vitin 2024 nga Niveli Qendror (Donatorët)

Niveli Qendror - Investimet Kapitale për vitin 2024		
INVESTIMET NGA DONATORËT - INSTITUCIONET TJERA NGA NIVELI QENDRORE(KUVENDI, AGJENCITË, KOMISIONET ETJ)		
Grant I donat. të brendshëm	€ 10,365.51	-
Qeveria e Shqipërisë	€ 2.00	-
Grante tjera të jashtme	€ 113.00	-
Qeveria Japoneze	€ 45,238.00	€ 45,238.00
Qeveria Japoneze	€ 66,695.00	€ 66,695.00
Tempus	€ 11.00	-
Qeveria Italiane	€ 71.00	-
Procredit Bank	€ 112.32	-
EU-Unioni European	€ 980.00	-
Qeveria Gjermane	€ 1,300.00	-
EU-Unioni European	€ 2,800.00	-
EU-Unioni European	€ 5,100.00	€ 4,787.62
Council Of Europe	€ 12,385.85	€ 9,786.00
EU-Unioni European	€ 17,000.00	-
EU-Unioni European	€ 17,500.00	-
GIZ	€ 22,878.50	€ 22,878.50
EU-Unioni European	€ 140,930.00	€ 72,047.99
Donacion I Paspecifikuar	€ 103,282.00	-
Të hyrat e dedikuara	€ 4,484.00	€ 4,484.00
Të hyrat e dedikuara	€ 5,550.00	€ 5,308.00
Të hyrat e dedikuara	€ 35,000.00	-
Të hyrat e dedikuara	€ 50,000.00	€ 50,000.00
Të hyrat e dedikuara	€ 50,000.00	-
Të hyrat e dedikuara	€ 180,000.00	€ 59,640.00
Të hyrat e dedikuara	€ 360,000.00	-
Të hyrat e dedikuara	€ 1,200,000.00	€ 1,020,000.85
Emiratet e Bashkuara Arabe	€ 6,000.00	€ 1,420.00
Gjithsej	€ 2,337,798.18	€ 1,362,285.96

Tabela 5. Investimet e përgjithshme kapitale për vitin 2024 nga Niveli Qendror (Donatorët)

NIVELI QENDROR - INVESTIMET KAPITALE 2024			
FINANCIMI NË MINISTRIT PËRKATËSE NGA BURIMI I FINANCIMIT			
61	Qeveria Zvicrane	€ 1,076.68	-
93	Council of Europe	€ 19,915.00	€ 19,915.00
49	EU-Unioni European	€ 95,695.50	€ 26,621.50
04	Financimet nga huamarrjet	€ 14,887,494.00	€ 13,568,899.68
06	Financimi nga huamarrje përmes klauzoles së investimeve	€ 64,977,634.00	€ 17,899,655.90
81	Global Fund	€ 15.12	-
31	Grant i donatorëve të brendshëm	€ 55,658.23	-
32	Grante tjera të jashtme	€ 386,636.20	€ 298,298.05
8A	Novartis Pharma Services	€ 4,093.00	-
54	Qeveria Italiane	€ 315,314.79	-
59	Qeveria Japoneze	€ 68,802.00	€ 6,290.40
73	USAID	€ 85,502.10	-
41	WB-Banka Botërore	€ 1,578,962.78	€ 632,402.53
	Gjithsej	€ 82,476,799.40	€ 32,452,083.06

Tabela 6. Sektorët e financuar nga Niveli Qendror(ministritë) v.2024

Nr.	Sektorët e financuar nga niveli qendror v.2024 (investimet e shpërndara nëpër rajone zhvillimore)	€
1	Ndërtimi I rrugëve	€ 43,460,748.32
2	Ndërtesa arsimore	€ 13,597,524.69
3	Objekte kulturore	€ 12,198,749.85
4	Ndërtesa administrative dhe afariste	€ 12,053,990.69
5	Objekte dhe fushat sportive	€ 10,459,640.82
6	Automjete	€ 7,863,454.26
7	Softuerët	€ 4,099,838.19
8	Pajisje e tjera	€ 3,979,740.96
9	Pajisjee tjera të teknologjisë informative dhe të komunikimit	€ 3,571,409.70
10	Pajisje policore	€ 3,189,394.04
11	Monumentet dhe komplekse memoriale	€ 2,812,349.32
12	Pajisje mjekësore	€ 2,638,988.10
13	Ndërtesa shëndetësore	€ 2,207,210.05
14	Ndërtesa banimi	€ 2,180,687.50
15	Mobile	€ 1,257,597.98
16	Zonat ekonomike	€ 1,243,491.61
17	Pajisje sportive	€ 1,147,583.84
18	Parqe dhe hapësira publike	€ 998,503.36
19	Trotuare	€ 815,265.68
20	Projekti IPA	€ 798,984.81
21	Të tjera / ndryshme	€ 793,100.56
22	Shtretërit e lumenjëve	€ 502,120.26
23	Depo	€ 479,035.31
24	Efiqenca	€ 414,978.44
25	Digjitalizimi	€ 393,284.59
26	Pajisje e metrologjisë	€ 387,480.00
27	Atraksion turistik	€ 263,350.00
28	Ura	€ 181,681.17
29	Rregullimi i lumenjëve	€ 154,460.83
30	Parqe kombëtare	€ 150,000.00
31	Kompjuter	€ 86,394.62
32	Zhvillim programesh	€ 68,833.35
33	Instalime hidrosanitare	€ 64,349.32
34	Sistemi i ujitjes	€ 60,987.00
35	Rrjetet e ujësjellësit	€ 9,198.36
36	Kanalizim	€ 8,234.00
	Gjithsej	€ 134,592,641.58

Figura 2. Pesë nga sektorët më të financuar investime kapitale nga Niveli Qendror për v.2024




Figura 3. Sektorët e financiar nga Niveli Qendror(ministritë) të padefinuara në rajone zhvillimore për v.2024





Figura 4. Shpërndarja e investimeve kapitale (të definuara) në shtatë rajone zhvillimore




Vlera totale e investimeve të realizuara nga niveli qendror(ministritë) gjatë vitit 2024 arrin 352,579,954.88 €. Nga kjo shumë investimet në vlerë prej 134,592,641.58 € të definuara në shtatë (7) rajone zhvillimore, si dhe investimet e realizuara në vlerë prej 217,987,313.30 € pa ndarje specifike sipas rajoneve zhvillimore si: shpronësimet, shpenzimet konfidenciale, investime në nivel të përgjithshëm të Kosovës etj.

Tabela 7. Totali i investimeve kapitale të shpërndara në shtatë rajonet zhvillimore për v.2024

RAJONET ZHVILIMORE NË KOSOVË	POPULLSIA E KOSOVËS - REGJISTRIMI 2024	VLERA E INVESTIMEVE KAPITALE TË PROJEKTEVE TË SHPËRNDARA NË KOMUNA	VLERA E INVESTIMEVE PËR KOKË BANORI
Rajoni Qendër	506,814	€ 51,872,539.61	€ 102.35
Rajoni Veri	190,591	€ 10,433,878.97	€ 54.74
Rajoni Perëndim	174,031	€ 18,687,836.71	€ 107.38
Rajoni Jug	227,498	€ 12,355,708.96	€ 54.31
Rajoni Juglindje	180,583	€ 19,754,716.25	€ 109.39
Rajoni Lindje	154,669	€ 10,990,118.78	€ 71.06
Rajoni Jugperëndim	168,329	€ 10,497,842.30	€ 62.37
Gjithsej	1,602,515	€ 134,592,641.58	€ 83.99

Në tabelën nr. 7 investimet kapitale për kokë banori janë llogaritur vetëm projektet kapitale të shpërndara në komuna të shtatë (7) rajoneve zhvillimore nga institucionet e nivelit qendror (ministritë) të analizuara nga totali i përgjithshëm i investimeve kapitale.

Figura 5. Investimet kapitale për kokë banori nga niveli qendror v. 2024



KAPITULLI II

II. SHPËRNDARJA E BALANCUAR E INVESTIMEVE KAPITALE TË MINISTRIVE TË LINJËS NË SHTATË (7) RAJONE ZHVILLIMORE

Në këtë kapitull janë pasqyruar investimet kapitale nga ministritë që realizojnë projekte kapitale me ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin socio-ekonomik rajonal, duke evidentuar rolin e tyre strategjik në zhvillimin socio-ekonomik të vendit. Klasifikimi i tillë mundëson një vlerësim të qartë të prioritetëve, shpërndarjes së investimeve dhe efektit të tyre në nivel kombëtar dhe rajonal.

Përmes realizimit të projekteve kapitale këto ministri përmes shpërndarjes rajonale të fondeve ndikojnë në zhvillimin ekonomik përmes përmirësimit të infrastrukturës publike, në komuna dhe rajone. Në këtë kapitull janë analizuar ministritë të cilat ndër vite kanë pasur shtrirje më të gjërë të investimeve kapitale në komuna dhe rajone, si:

MZHR – Ministria e Zhvillimit Rajonal;

MAPL – Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;

MKRS – Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;

MASHT – Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;

MINT – Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;

MMPHI – Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;

MKK – Ministria për Komunitet dhe Kthim;

MBPZHR – Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ;

ME- Ministria e Ekonomisë.

Projektet kapitale për vitin 2024 të e ministrive të linjës janë analizuar sipas:

- vlerës totale të planifikuar dhe të shpenzuar financiare;
- projektet totale të planifikuara dhe të realizuara;
- vlerës së shpenzuar financiare në komuna brenda rajoneve zhvillimore;
- komunat përfituese dhe jo-përfituese brenda rajonit;
- sektorët më të financuar;
- mesatarja e diskrepancës në rajone zhvillimore;

2.1 Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe shpërndarja e balancuar e investimeve kapitale për vitin (2024) sipas shtatë (7) rajoneve zhvillimore:

Ministria e Zhvillimit Rajonal gjatë vitit 2024 ka realizuar plotësisht 24 projekte kapitale nga 24 të planifikuara, të shtrira në 21 komuna të vendit. Zbatimi i këtyre projekteve ka kontribuar në përmirësimin e infrastrukturës publike dhe në mbështetjen e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar.

Gjatë vitit 2024 Ministria e Zhvillimit Rajonal ka realizuar investime kapitale në sektorë të ndryshëm duke përfshirë: ndërtesat administrative dhe afariste, objektet arsimore dhe kulturore, ndërtimin e rrugëve dhe trotuareve, projekt për zhvillimin e programeve, blerjen e automjeteve, rregullimin e parqeve dhe hapësirave publike, zhvillimin e atraksioneve turistike, si dhe rregullimin e shtretërve të lumenjve.

Buxheti i planifikuar për vitin 2024 ka qenë 2,991,457.00 €, ndërsa shpenzimet e realizuara kanë arritur 2,883,685.64 €, që përfaqëson një normë realizimi prej 96%. Në total, nga investimet e realizuara kanë përfituar 21 komuna, ndërsa 17 komuna nuk kanë qenë përfituese gjatë këtij viti.

Tabela 8. Totali i investimeve dhe i projekteve të financuara nga Ministria e Zhvillimit Rajonal në shtatë (7) rajone zhvillimore v.2024

MINISTRIA E ZHVILLIMIT RAJONAL							
Shtatë (7) Rajonet Zhvillimore	Numri i projekteve të planifikuara (2024)	Numri i projekteve të realizuara (2024)	Nr. i Komunave përfituese (2024)	Buxheti Aktual/ Planifikuar v.2024	Aktuali/Shpenzuar v.2024	Përqindja e realizimit %	Komunat jo-përfituese 2024
Gjithsej	24	24	21	€ 2,991,457.00 €	€ 2,883,685.64 €	96%	17

Figura 6. Sektorët e financuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal për vitin .2024




Figura 7. Sektorët e financuar në % nga Ministria e Zhvillimit Rajonal për vitin 2024




Tabela 9 . Projektet e financuara nga Ministria e Zhvillimit Rajonal në shtatë (7) rajone zhvillimore për vitin 2024, sipas vlerës financiare dhe sektorit

Ministria e Zhvillimit Rajonal													
	Komuna	Vlera e financiar	Ndërtesat administrative dhe afariste	Objektet arsimore	Objektet kulturore	Ndërtimi rrugëve	Trotualet	Zhvillim Programesh	Automjete	Parqe dhe hapësirapublik	Atraksion turistik	Rregullimi I lumenjëve	Komunat e pa financiar
Qendër	Glllogoc	120,000.00								120,000.00			Obiliq, Graçanicë
	Fushë Kosovë	70,000.00								70,000.00			
	Lipjan	130,000.00			130,000.00								
	Obiliq	-											
	Podujevë	500,000.00	300,000.00										
			200,000.00										
	Prishtinë	234,434.32						20,060.00	170,085.00				
								44,289.32					
	Graçanicë	-											
	Total	€ 1,054,434.32											2
Veri	Mitrovicë	-											Mitrovicë, Mitrovicë Veriut, Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan
	Mitrovicë e Veriut	-											
	Leposaviq	-											
	Skënderaj	209,981.65		209,981.65									
	Vushtrri	120,000.00					120,000.00						
	Zubin Potok	-											
	Zveçan	-											
	Total	€ 329,981.65											5
Perëndim	Deçan	53,350.00									53,350.00		
	Istog	70,000.00	70,000.00										
	Klinë	140,000.00					140,000.00						

	Pejë	120,000.00				120,000.00							
	Total	€ 383,350.00											0
Jug	Dragash	55,000.00							55,000.00				Prizren, Suharekë, Mamushë
	Prizren	-											
	Suharekë	-											
	Mamushë	-											
	Total	€ 55,000.00											3
Juglindje	Kaçanik	-											Shtërpçë, Kaçanik
	Shtime	140,000.00	140,000.00										
	Shtërpçë	-											
	Ferizaj	80,000.00								80,000.00			
	Hani I Elezit	80,000.00				80,000.00							
	Total	€ 300,000.00											2
Lindje	Gjilan	241,104.67			241,104.67								Kamenicë, Novobërdë , Partesh
	Kamenicë	-											
	Novobërdë	-											
	Viti	95,964.20	95,964.20										
	Ranillug	50,000.00							50,000.00				
	Partesh	-											
	Klllokot	150,000.00										150,000.00	
	Total	€ 537,068.87											3
Jugperëndim	Gjakovë	93,850.80	93,850.80										Malishvë, Junik
	Rahovec	130,000.00								130,000.00			
	Malishevë	-											
	Junik	-											
	Total	€ 223,850.80											2

Figura 8. Investimet Kapitale nga Ministria e Zhvillimit Rajonal në shtatë (7) rajone zhvillimore





Figura 9. Investimet Kapitale në % nga Ministria e Zhvillimit Rajonal në shtatë (7) rajone zhvillimore



Mesatarja e diskrepancës në mes të rajoneve zhvillimore është 7.8 %.

2.2 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe shpërndarja e balancuar e investimeve kapitale për periudhën (2024) sipas shtatë (7) rajoneve zhvillimore

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) gjatë vitit 2024 ka realizuar 33 projekte kapitale nga gjithsej 36 projekte të planifikuara, të zbatuara në 19 komuna të vendit. Duke pasur ndikim në përmirësimin e kapaciteteve lokale dhe në mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm në nivel komunal.

Buxheti i planifikuar për vitin 2024 ka qenë 4,950,000.00 €, ndërsa shpenzimet e realizuara kanë arritur në 4,026,495.81 €, që përfaqëson një normë realizimi prej 81% të buxhetit total.

Projektet kapitale janë zbatuar në sektorë të ndryshëm dhe gjithëpërfshirës, duke përfshirë : ndërtesa administrative dhe afariste, ndërtesatë banimit, ndërtesa shëndetësore, objekte arsimore, si dhe objekteve dhe fushave sportive. Po ashtu, investimet kanë përfshirë ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës rrugore lokale, trotuareve, sistemeve të kanalizimit, rregullimin e shtretërve të lumenjve, zhvillimin e parqeve dhe hapësirave publike, investime në softuerë, si dhe projekte të tjera me rëndësi për zhvillimin lokal.

Tabela 10. Totali i investimeve dhe i projekteve të financuara nga MAPL në shtatë (7)rajone zhvillimore v.2024

MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL							
INVESTIMET KAPITALE (2024)							
Shtatë (7) Rajonet Zhvillimore	Numri i projekteve të planifikuara (2024)	Numri i projekteve të realizuara (2024)	Nr. i Komunave përfituese (2024)	Buxheti Aktual/ Planifikuar v.2024	Aktuali/Shpenzuar v.2024	Përqindja e realizimit %	Komunat jo-përfituese 2024
Gjithsej	36	33	19	€ 4,950,000.00	€ 4,026,495.81	81%	19

Figura 10. Sektorët e financuar për vitin 2024, nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal




Figura 11. Sektorët e financuar në % për vitin 2024, nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal




Tabela 11. Projektet e financuara nga Ministria e Administimit të Pushtetit Lokal në shtatë(7) rajone zhvillimore për vitin 2024, sipas vlerës financiare dhe sektorit

Ministria e Administimit të Pushtetit Lokal															
	Komuna	Vlera e financiar	Ndërtesat administrative dhe afërisht	Ndërtesa banimi	Ndërtesat shëndetësor	Objekte arsimore	Objektet dhe fushat sportive	Ndërtimi rrugëve lokale	Trotuaret	Kanalizim	Shtretërit e lumenjëve	Parqe dhe hapësira publike	Softuerët	Të tjera	Komunat e pa financuar
Qendër	Glllogoc	-													Glllogoc, Fushë Kosovë, Lipjan, Graçanicë
	Fushë Kosovë	-													
	Lipjan	-													
	Obiliq	388,299.91					88,110.53								
							250,189.38								
							50,000.00								
	Podujevë	67,259.66												67,259.66	
	Prishtinë	76,865.20											76,865.20		
	Graçanicë														
Total	€ 532,424.77													4	
Veri	Mitrovicë	-													Mitrovicë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Vushtrri, Zubin Potok, Zveçan
	Mitrovicë Veriore	-													
	Leposaviq	-													
	Skënderaj	471,313.00				26,208.00						338,200.00			
					106,905.00										

	Vushtrri	-													
	Zubin Potok	-													
	Zveçan	-													
	Total	€ 471,313.00													6
Perëndim	Deçan	-													Deçan, Istog,
	Istog	-													
	Klinë	50,000.00												50,000.00	
	Pejë	703,195.34		39,819.16	49,277.00		56,000.00		34,400.00			10,024.00		80,000.00	
									40,797.64			52,000.00			
									39,708.00			30,373.64			
									52,795.90						
									64,000.00						
									104,000.00						
	Total	€ 703,195.34													2
Jug	Dragash	223,994.17						173,994.17						50,000.00	Prizren
	Prizren	-													
	Suharekë	359,672.19						45,000.00							
			234,672.19					80,000.00							
	Mamushë	50,000.00												50,000.00	
	Total	€ 633,666.36													1
Juglindje	Kaçanik	60,364.92										60,364.92			Shtërpçë, Hani I Elezit
	Shtime	190,798.43										190,798.43			
	Shtërpçë	-													
	Ferizaj	50,000.00												50,000.00	
	Hani Elezit	-													
	Total	€ 301,163.35													2

Lindje	Gjilan	-													Gjilan, Viti, Klllokot
	Kamenicë	97,594.09												97,594.09	
	Novobërdë	70,000.00												70,000.00	
	Viti	-													
	Ranillug	16,219.02	16,219.02												
	Partesh	8,413.87										8,413.87			
	Klllokot	-													
Jugperëndim	Total	€ 192,226.98													3
	Gjakovë	-													Gjakovë
	Rahovec	790,385.75	30,000.00				189,990.30	424,205.48		146,189.97					
	Malishevë	352,120.26									302,120.26			50,000.00	
	Junik	50,000.00												50,000.00	
	Total	€ 1,192,506.01													1

Figura 12. Investimet Kapitale nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në shtatë (7) rajone zhvillimore





Figura 13. Investimet Kapitale në % nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në shtatë (7) rajone zhvillimore



Mesatarja e diskrepancës në mes të (7) rajoneve zhvillimore është 5.7%.

2.3 Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe shpërndarja e balancuar e investimeve kapitale për vitin 2024 sipas shtatë (7) rajoneve zhvillimore

Gjatë vitit 2024, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka planifikuar 176 projekte zhvillimore në të gjithë rajonet e vendit. Nga këto, janë realizuar 132 projekte në 27 komuna.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka realizuar investime kapitale në sektorë të ndryshëm duke përfshirë: ndërtesat administrative dhe afariste, objektet kulturore dhe të trashëgimisë kulturore, ndërtesat arsimore, monumentet dhe komplekset memoriale, ndërtesat shëndetësore, objektet dhe fushat sportive, pajisje të teknologjisë informative dhe të komunikimit, automjete, si dhe pajisje të tjera.

Buxheti i planifikuar për investimet kapitale ishte 43,126,166.27 €, ndërsa janë shpenzuar 26,172,158.30 €, me realizim prej 61% të buxhetit të planifikuar.

Tabela 12. Totali i investimeve dhe i projekteve të financuara nga MKRS në shtatë (7)rajone zhvillimore v.2024

MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT							
INVESTIMET KAPITALE (2024)							
